



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P.527/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 20.11.2020 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së BOE “Eurondërtimi 2000” shpk & “Dion-Al” shpk dhe kualifikimin e ofertës së operatorit “Colombo” shpk në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me nr. REF-67868-08-05-2020, me objekt “*Rikonstruksion i disa QSH- ve në qarqet Gjirokastër, Vlorë dhe Fier*”, me fond limit 130,414,007 lekë pa tvsh zhvilluar në datën 14.09.2020 nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
- Ankimues:** BOE “Eurondërtimi 2000” shpk & “Dion-Al” shpk
Rruga e Kavajës, Pallati 114, Shk.1, Kati.2, Ap.2 Tiranë
- Autoriteti Kontraktor:** Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
Rruga e Kavajës, nr. 1001, Tiranë
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar, Vendimi

i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Vlerësimi paraprak

1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 05.08.2020 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me nr.REF-67868-08-05-2020, me objekt “*Rikonstruksion i disa QSH- ve në qarqet Gjirokastër, Vlorë dhe Fier*”, me fond limit 130,414,007 lekë pa tvsh zhvilluar në datën 14.09.2020 nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

II.2. Në datën 14.09.2020 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton se në datën 06.10.2020 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- Ina	81,593,017	I skualifikuar
- 2N	85,002,214	I skualifikuar
- Kevin Construction	88,732,895	I skualifikuar
- Eurondërtimi 2000	89,056,719.00	I kualifikuar
- Colombo	89,487,258	I kualifikuar
- B93II	89,827,176.60	I kualifikuar
- Everset	89,974,067.00	I kualifikuar
- Ndregjoni	91,797,264	I kualifikuar
- Sireta 2F	92,685,564	I kualifikuar
- Avduli	92,953,475	I kualifikuar
- Vega	97,833,443	I skualifikuar
- Spektri	98,625,157	I kualifikuar
- Mane/S	102,117,515	I kualifikuar
- Leon Konstruksion	108,412,358.65	I kualifikuar
- Zdravo	110,625,209	I skualifikuar
- G.P.G Company	118,681,292	I kualifikuar

II.4. Në datën 23.10.2020 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e rivlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- Ina	81,593,017	I skualifikuar
- 2N	85,002,214	I skualifikuar
- Kevin Construction	88,732,895	I skualifikuar
- Eurondërtimi 2000	89,056,719.00	I skualifikuar
- Colombo	89,487,258	I kualifikuar
- B93II	89,827,176.60	I kualifikuar
- Everset	89,974,067.00	I kualifikuar
- Ndregjoni	91,797,264	I kualifikuar
- Sireta 2F	92,685,564	I kualifikuar
- Avduli	92,953,475	I kualifikuar
- Vega	97,833,443	I skualifikuar
- Spektri	98,625,157	I kualifikuar
- Mane/S	102,117,515	I kualifikuar
- Leon Konstruksion	108,412,358.65	I kualifikuar

- Zdravo	110,625,209	I skualifikuar
- G.P.G Company	118,681,292	I kualifikuar

II.5. Në datën 23.10.2020 BOE “Eurondërtimi 2000” shpk & “Dion-AL” shpk është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon.

- *Bashkimi i Operatoreve Ekonomik: Eurondërtim 2000 dhe DION-AL s'kualifikohet sipas vendimit të KSHA lidhur me ankesën e bërë nga operatori ekonomik COLOMBO për arsyet e mëposhtme:*
- *BOE nuk ka përmbushur kriterin e vecante 2.3.8 dhe 2.3.10 të DST në përputhje me nenin 74, pika 3, e VKM nr . 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, është parashikuar si më poshtë vijon: “3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP-së dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 6, të nenit 26, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.”*
- *1. Konkretisht në baze të % të bashkepunimit Operatori Dion-AL (pjesë e bashkimit të operatoreve) nuk plotëson nr e kerkuar për punonjesit sipas pikes 2.3.8:*
- *Punonjes elektrikist – Kerkohen sipas % se bashkepunimit 3. Ka paraqitur 0*
- *Punonjes hidraulik/mekanik –Kerkohen sipas % se bashkepunimit 3. Ka paraqitur 0*
- *Punonjes pllakashtrues – Kerkohen sipas % se bashkepunimit 2. Ka paraqitur 0*
- *Punonjes bojaxhi – Kerkohen sipas % se bashkepunimit 2. Ka paraqitur 1*
- *Punonjes saldator – Kerkohen sipas % se bashkepunimit 1. Ka paraqitur 0*
- *Konkretisht në baze të % të bashkepunimit Operatori Dion-AL (pjesë e bashkimit të operatoreve) nuk plotëson nr e kerkuar për pajisjet sipas pikes 2.3.10:*
- *Kamioncine deri 3 ton kapaciteti mbajtes për secilen– Kerkohen sipas % se bashkepunimit 3. Ka paraqitur 2*

- Kamion per furnizimin me materiale dhe largimin e mbeturinave nga objekti me goma dhe kapacitet mbajtes 5-10 ton dhe vetshkarkues – Kerkohen sipas % se bashkepunimit 2. Ka paraqitur 1
- Elektrobetoniere/betoniere per pergatitje betoni dhe llaci ne objekt me kapacitet min 0.3m³ – Kerkohen sipas % se bashkepunimit 5. Ka paraqitur 3
- Motogjenerator me fuqi deri 5kva – Kerkohen sipas % se bashkepunimit 5. Ka paraqitur 0
- Elektrovinc (i levizshem) me karel te levizshem horizontalisht me kapacitet ngrites 0.3-0.5 ton – Kerkohen sipas % se bashkepunimit 2. Ka paraqitur 0
- Matrapik – Kerkohen sipas % se bashkepunimit 3. Ka paraqitur 2
- Nivelues betoni – Kerkohen sipas % se bashkepunimit 3. Ka paraqitur 1
- Ekskavator goma ose zinxhir 0.25 m³ – Kerkohen sipas % se bashkepunimit 1 Ka paraqitur 0
- Depozita uji 1.000 lt – Kerkohen sipas % se bashkepunimit 7. Ka paraqitur 4
- Pompe suvatimi – Kerkohen sipas % se bashkepunimit 5. Ka paraqitur 1

II.6. Në datën 28.10.2020 BOE “Eurondërtimi 2000” shpk & “Dion-Al” shpk ka paraqitur ankesën pranë autoritetit kontraktor në mënyrë të përmbledhur me argumentat si më poshtë:

- Më datë 23.10.2020 njoftohemi nëpërmjet SPE për refuzimin e ofertës sonë dhe skualifikimin e saj dhe shpalljen fituese të ofertës nga operatori ekonomik Colombo. Arsyet e skualifikimit që KVO ka vendosur në sistem normalisht janë të diktuar nga KSHA për të cilat po paraqesim me fakte dhe argumenta pse vendimi i KSHA është i jashtëligjshëm ndërsa vendimi i parë i KVO për shpalljen fituese të ofertës tonë ishte i drejtë.
- Së pari bazuar në LPP nr.9643 datë 20.11.2006 i ndryshuar neni 25 ku citohet: Pa cënuar dispozitat e këtij ligji mbi detyrimin për botimin e kontratave të prokurimit dhe të informacioneve për kandidatët dhe ofertuesit sipas neneve 21 e 57 të këtij ligji autoriteti kontraktor nuk duhet të bëjë publik informacionet e marra nga operatorët ekonomikë të etiketuara si konfidenciale. Ky lloj infomacioni përfshin vecanërisht aspektet teknike sekretet tregëtare dhe informacionet konfidenciale të ofertave.
- Në dokumentacionin e ngarkuar në sistem nga BOE me përfaqësues Eurondërtimi 2000 shpk mund të gjeni lehtësisht shtojcën 4 mbi listën e informacionit konfidencial e cila mbështetet në nenin e sipërpërmendur dhe në këtë rast veprimi i marrë nga AK ka

dëmtuar direkt BOE me përfqësues Eurondërtimi 2000 shpk duke shkelur në mënyrë të hapur ligjin pasi kemi bindjen se dokumentet tona konfidenciale i janë vënë në dispozicion pa asnjë rezervë një konkurenti tjetër si pasojë e rrjedhjes së informacionit nga KVO. Për këtë shkelje ju drejtohem ju si AK të kryeni detyrën tuaj duke hetuar të gjithë procesin e prokurimit duke pasur parasysh këtë fakt për të cilin jemi të detyruar ti drejtohem edhe APP dhe organeve të tjera ligjore.

- Së dyti bazuar në VKM 914/2014 neni 74 pika 1 dhe 5 ku parashikohet se:
- 1.Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi.
- 5.Në rast falimentimi të përfaqësuesit të bashkimit të operatorëve ekonomikë ose në rrethana të tjera, që ndërpresin veprimtarinë e tij gjatë zbatimit të kontratës, autoriteti kontraktor mund të vazhdojë kontratën me një operator tjetër ekonomik, anëtar të bashkimit, me kusht që ai të zotërojë kapacitetet ligjore, ekonomike, financiare dhe teknike për të zbatuar kontratën. Përndryshe, autoriteti kontraktor zgjidh kontratën. Në rast se këto rrethana I ndodhin operatorit tjetër ekonomik, atëherë detyrimet e operatorit të dështuar ekonomik mund të merren përsipër nga përfaqësuesi ose nga një anëtar tjetër i bashkimit, me kusht që ky të plotësojë kërkesat.

Vendimi për skualifikimin e ofertës së Eurondërtim 2000 shpk nuk është i drejtë pasi arsyet e skualifikimit janë trajtuar si të vecanta për secilin anëtar të BOE dhe jo si një e tërë. I sjellim në vëmendje AK se ai ka pranuar ofertë nga OE me emërtimin BOE Eurondërtimi 2000 shpk & Dion Al shpk dhe jo nga Dion Al shpk.

Gjithashtu i sjellim në vëmendje AK të lexojë edhe DT ku specifikisht thuhet: Për certifikatat e cilësisë në rastet e BOE cdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatat e kërkuara të cilësisë sipas zërave që merr përsipër të realizojë një akt marrëveshje. Për punët e ngjashme pika 2.3.2/a plotësohet nga anëtari I cili ka përqindjen më të madhe të pjesmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme në raport me përqindjen e pjesmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2.3.3/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesmarrjes së tyre në bashkim.

Këto dy pika janë plotësuar vec e vec sikurse kërkohet në DT dhe në asnjë pikë tjetër të DT nuk cilësohet se do të bëhet vlerësim individual për secilin operator pasi atëherë nuk do të kishte kuptim BOE dhe rrjedhimisht AK nuk duhej ta konsideronte as ofertën e BOE Eurondërtimi 2000 shpk & Dion shpk por duhej të kërkonte ofertë edhe nga Eurondërtimi 2000 shpk dhe nga Dion Al shpk pasi edhe vlerësimin po e bën vec e vec dhe jo në tërësi për kapacitetet njerëzore dhe teknike ashtu sikurse realisht duhet të bëhet.

Duke supozuar që KSHA e ka lexuar marrëveshjen e bashkëpunimit ndërmjet operatorëve Eurondërtimi 2000 shpk dhe Dion Al shpk duhet të ishte ndalur te kushtet e kontratës në të cilat thuhet shprehimisht se operatorët ekonomikë bashkojnë mjetet e veta teknike, inxhinierike dhe financiare për plotësimin e detyrimeve që kërkon

investitori duke u përfaqësuar nga Eurondërtimi 2000 shpk. Pra ndarja e punimeve dhe fitimeve do të jetë në raportin 45 % për Eurondërtimi 2000 shpk dhe 55% Dion Al shpk por nuk është përmendur në asnjë vend një ndarje në % e angazhimit të mjeteve teknike, inxhinerike dhe financiare të secilit operator. Kjo do të thotë se në këtë procedurë ky bashkim operatorësh është trajtuar si një i tërë (si një operator i vetëm) me qëllim përmbushjen e kriterëve për realizimin e kësaj kontrate. AK e ka shumë të qartë që oferta është sjellë nga BOE Eurondërtimi 2000 shpk & Dion Al shpk dhe jo vetëm nga operatori Dion Al shpk.

Sikurse e dini edhe nga shqyrtimi i dokumentacionit arsytet e vendosura për skualifikimin e ofertës së operatorit BOE Eurondërtimi 2000 shpk & Dion Al shpk plotësohen dhe në disa raste tejkalohen nga Eurondërtimi 2000 shpk dhe jo më si BOE

Arsyeja e skualifikimit të ofertës sonë bie ndesh me nenin e sipërcituar pasi oferta jonë përmban devijime të vogla që nuk ndryshojnë aspak nga kërkesat dhe kushtet e paracaktuara dhe nuk çënojnë përmbajtjen e kësaj procedure dhe kontrate.

Pavarësisht këtyre devijimeve të vogla të cilat mund të vërehet lehtësisht edhe nga verifikimet e KVO dhe të KSHA BOE me përfaqësues Eurondërtimi 2000 shpk i realizon madje në disa raste i tejkalon kërkesat e AK për stafin e kërkuar dhe për mjete teknike.

Ashtu sikurse keni konkluduar edhe ju në vlerësimin e datës 06.10.2020 për këtë tender BOE Eurondërtimi 2000 shpk & Dion Al shpk i plotëson 1000% të gjitha kriteret e kërkuara dhe gëzojmë se jemi partneri më i besueshëm për të realizuar me sukses këtë kontratë pa asnjë vonesë dhe problem pasi nuk kemi asnjë reklamim për raste të kundërta gjatë gjithë eksperiencës sonë.

Si përfundim kërkojmë revokimin e vendimit të KSHA datë 23.10.2020 dhe kualifikimin si ofertë e sukseshme dhe shpalljen fitues të BOE Eurondërtimi 2000 shpk & Diona Al shpk sipas vendimit të KVO datë 06.10.2020.

II.7. Në datën 30.10.2020 me shresën nr.3681/23 prot BOE ankimues ka marrë dijeni lidhur me mospranimin e ankesës nga autoriteti kontraktor.

II.8. Në datën 09.11.2020 BOE ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik ku përvec pretendimeve të sipërcituara drejtuar autoritetit kontraktor ka pretenduar gjithashtu edhe skualifikimin e operatorit ekonomik “Colombo” shpk.

II.9. Nëpërmjet shkresës nr.30681/26 prot datë 18.11.2020 protokolluar me tonën me nr.1448/2 prot datë 19.11.2020 me objekt “Dërgohet informacioni”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Në lidhje me pretendimin e BOE “Eurondërtimi 2000” shpk & “Dion-AL” shpk për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyetimin se “BOE nuk ka përmbushur kriterin e vecante 2.3.8 të DST ne përputhje me nenin 74, pika 3, e VKM nr . 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, është parashikuar si më poshtë vijon: “3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP-së dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 6, të nenit 26, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.”

Konkretisht ne baze te % te bashkepunimit Operatori Dion-AL (pjesë e bashkimit te operatoreve) nuk ploteson nr e kerkuar per punonjesit sipas pikes 2.3.8:

Punonjes elektrikist – Kerkohen sipas % se bashkepunimit 3. Ka paraqitur 0

Punonjes hidraulik/mekanik –Kerkohen sipas % se bashkepunimit 3. Ka paraqitur 0

Punonjes pllakashtrues – Kerkohen sipas % se bashkepunimit 2. Ka paraqitur 0

Punonjes bojaxhi – Kerkohen sipas % se bashkepunimit 2. Ka paraqitur 1

Punonjes saldator – Kerkohen sipas % se bashkepunimit 1. Ka paraqitur 0”, Komisioni i Prokurimit Pubik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 12 “Kriteret e vecanta të kualifikimit” pika 2.3.8 “Kapaciteti teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

- *Të ketë në stafin e punonjesve te pasqyruar ne list pagesa punonjës të pajisur me deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga IQT ose ekuivalente me te, të vlefshme: 5(pese) punonjës elektrikist; 5 (pese) punonjës hidraulik/mekanik; 4(kater) punonjës murator 3(tre) punonjës pllakashtrues; 3 (tre) punonjes bojaxhi; 2 (dy) saldatore. Per punonjesit e siperpermendur te paraqiten deshmitë perkatese te kualifikimit te sigurimit teknik si dhe kontrata e punes (te vlefshme).*

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se BOE “Eurondërtimi 2000” shpk & “Dion-Al” shpk në përmbushje të kriterit sa më sipër kanë dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Marrëveshje Bashkëpunimi për bashkimin e përkohshëm të operatorëve ekonomikë Nr.6319 prot Nr.4136 Kol datë 03.09.2020 lidhur mes shoqëria ”Eurondërtim 2000” shpk dhe shoqëria ”Dion-Al” shpk për realizimin e objektit “Rikonstruksion i disa QSH-ve në qarqet Gjirokastrë, Vlorë dhe Fier”, që zhvillohet nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Në nenin 3 “Pjesmarrja” të marrëveshjes parashikohet se: Shoqëria “Eurondërtimi 2000” shpk 45 % të punimeve sipas preventivit të firmosur e vulosur nga palët. Shoqëria “Dion-Al” shpk 55 % të punimeve sipas preventivit të firmosur e vulosur nga palët. Shoqëria “Eurondërtim 2000” shpk merr përsipër realizimin në masën 45% të punimeve sipas preventivit ndarë punimet firmosur e vulosur nga palët. Shoqëria “Dion Al” shpk merr përsipër realizimin në masën 55% të punimeve të preventivit sipas preventivit ndarë punimet firmosur e vulosur nga palët. (Bashkëngjitur marrëveshjes gjendet preventivi i punimeve ku përcaktohet se të gjithë zërat e punimeve do të realizohen përkatësisht 45 % nga shoqëria Eurondërtimi shpk dhe 55 % nga shoqëria Dion-Al shpk.
- Kontratë Individuale Pune datë 31.03.2020 lidhur ndërmjet “Eurondërtimi 2000” shpk në cilësinë e punëdhënësit dhe Qani Ismaili në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin MURATOR DHE SPECIALIST NDËRTIMI.
- Kontratë Individuale Pune datë 29.03.2020 lidhur ndërmjet “Eurondërtimi 2000” shpk në cilësinë e punëdhënësit dhe “Xhevit Qafa” në cilësinë e punëmarrësit, në pozicionin e SPECIALIST PËR MONTIM TUBASH , MURATOR DHE PLLAKASHTRUES.
- Kontratë Individuale Pune date 06.01.2020 lidhur ndërmjet “Eurondërtimi 2000” shpk në cilësinë e punëdhënësit dhe behar Sinanaj në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin VINCIER, MURATOR, BOJAXHI.
- Kontratë Individuale Pune date 05.01.2020 lidhur ndërmjet “Eurondërtimi 2000” shpk në cilësinë e punëdhënësit dhe Dëfrim Gjinollari në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin SALDATOR DHE HIDROIZOLUES.
- Kontratë Individuale Pune date 05.01.2020 lidhur ndërmjet “Eurondërtimi 2000” në cilësinë e punëdhënësit dhe Sokol Saraci në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin VINCIER, SALDATOR DHE HIDRAULIK.
- Kontratë Individuale Pune date 06.01.2020 lidhur ndërmjet “Eurondërtimi 2000” shpk në cilësinë e punëdhënësit dhe Jetmir Latifi në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin MANOVRATOR, MEKANIK,ESKAVATORIST.
- Kontratë Individuale Pune date 07.05.2020 lidhur ndërmjet “Eurondërtimi 2000” shpk në cilësinë e punëdhënësit dhe Orges Kurti në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin HIDRAULIK DHE SUVATUES

- Kontratë Pune lidhur ndërmjet “Eurondërtimi 2000” shpk në cilësinë e punëdhënësit dhe Shkëlzen Dina në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin MANOVRATOR, MEKANIK DHE SHOFER.
- Kontratë Individuale Pune lidhur ndërmjet “Eurondërtimi 2000” shpk në cilësinë e punëdhënësit dhe Andi Menkshi në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin MANOVRATOR,MEKANIK DHE AUTOMAKINIST.
- Kontratë Individuale Pune lidhur ndërmjet shoqërisë “Eurondërtimi 2000” shpk në cilësinë e punëdhënësit dhe Dhurata Saraci në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin MEKANIKE.
- Kontratë Individuale Pune lidhur ndërmjet shoqërisë “Eurondërtimi 2000” shpk në cilësinë e punëdhënësit dhe Lulëzim Ibro në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin BOJAXHI DHE SPECIALIST NDËRTIMI.
- Kontratë Individuale Pune lidhur ndërmjet shoqërisë “Eurondërtimi 2000” shpk në cilësinë e punëdhënësit dhe Adi Hysa në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin BOJAXHI DHE KARPENTIER.
- Kontratë Individuale Pune lidhur ndërmjet shoqërisë “Eurondërtimi 2000” shpk në cilësinë e punëdhënësit dhe Jaho Xhaferi në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin ELEKTICIST DHE HIDRAULIK.
- Kontratë Individuale Pune lidhur ndërmjet shoqërisë “Eurondërtimi 2000” shpk në cilësinë e punëdhënësit dhe Klodjana Saraci në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin ELEKTRICISTE.
- Kontratë Individuale Pune lidhur ndërmjet shoqërisë “Eurondërtimi 2000” shpk në cilësinë e punëdhënësit dhe Alketa Hoxha në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin PUNONJËSE ELEKTRIKE.
- Kontratë Individuale Pune lidhur ndërmjet shoqërisë “Eurondërtimi 2000” shpk në cilësinë e punëdhënësit dhe Besim Hidri në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin ELEKTRICIST DHE MURATOR.
- Kontratë Individuale Pune lidhur ndërmjet shoqërisë “Eurondërtimi 2000” shpk në cilësinë e punëdhënësit dhe Denis Osmanllari në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin ELEKTRICIST, HIDRAULIK DHE SALDATOR.
- Kontratë Individuale Pune lidhur ndërmjet shoqërisë “Eurondërtimi 2000” shpk në cilësinë e punëdhënësit dhe Niko Haxhi në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin TEKNIK NDËRTIMI, MURATOR DHE SHTRUES PLLAKASH.
- Kontratë Individuale Pune lidhur ndërmjet shoqërisë “Eurondërtimi 2000” shpk në cilësinë e punëdhënësit dhe Hekuran Agolli në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin PUNONJËS MIRËMBAJTJE DHE PLLAKASHTRUES.
- Kontratë Individuale Pune lidhur ndërmjet shoqërisë “Eurondërtimi 2000” shpk në cilësinë e punëdhënësit dhe Ledion Ismaili në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin SHTRUES PLLAKASH DHE HIDROIZOLUES.

- Kontratë Individuale Pune lidhur ndërmjet shoqëria “Dion-Al” shpk në cilësinë e punëdhënësit dhe Zamir Cela në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin MURATOR.
- Kontratë Individuale Pune lidhur ndërmjet shoqëria “Dion-Al” shpk në cilësinë e punëdhënësit dhe Dritan Koxha në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin MURATOR.
- Kontratë Individuale Pune lidhur ndërmjet shoqëria “Dion-Al” shpk në cilësinë e punëdhënësit dhe Bardhyl Basha në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin BOJAXHI.
- Kontratë Individuale Pune lidhur ndërmjet shoqëria “Dion-Al” shpk në cilësinë e punëdhënësit dhe Rrustem Gjonaj në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin MURATOR.

III.1.3. Në Kreun VIII (“Kushte të përgjithshme për zbatim”), neni 74 (“Bashkimi i operatorëve ekonomikë”), pika 1, dhe 3 të VKM 914/2014 parashikohet se :

“1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi.....

2. Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, nëse kërkohet, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë. Në rast se bashkimi I operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi.

“3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.

III.1.4. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”*

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*

III.1.5. Neni 26, pika 5, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se : *Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:*

- a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;dhe/ose*
- b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;dhe/ose*
- c) c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushurkontratën.*

III.1.6. Komisioni i Prokurimit Publik referuar bazës ligjore të sipërcituar gjykon se përmbushja e kriterëve duhet të bëhet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen e marrë përsipër për realizimin me sukses të kontratës.

Komisioni referuar dokumentacionit sa më sipër të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimes në përmbushje të kriterit kualifikues lidhur me numrin e punonjësve konstaton se anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Dion-AL” sh.p.k referuar marrëveshjes së bashkëpunimit ka marrë përsipër kryerjen e 55 % të volumit të punimeve të kontratës. Nga ana e autoritetit kontraktor në dokumentat e procedurës së prokurimit objekt ankimi është kërkuar disponimi nga ana e operatorëve ekonomikë të *5(pese) punonjës elektrikist; 5 (pese) punonjës hidraulik/mekanik; 4(kater) punonjës murator 3(tre) punonjës pllakashtrues; 3 (tre) punonjës bojaxhi; 2 (dy) saldatore*. Në këto kushte KPP gjykon se operatori ekonomik “Dion-AL” sh.p.k referuar përqindjes së marrë përsipër duhet të dëshmonte me anë të dokumentacionit se disponon për secilin nga specialitetet e kërkuara më lart një numër të caktuar punonjësish pasi referuar ndarjes së punimeve në preventivin bashkëngjitur marrëveshjes së bashkëpunimit operatori ekonomik “Dion Al” shpk për cdo zë punimi qofshin këto punime elektrike hidraulike mekanike etj ka marrë përsipër të realizojë 55% të volumit të punimeve. Konkretisht operatori ekonomik “Dion –AL” sipas marrëveshjes së bashkëpunimit, ndarjes së zërave në preventiv dhe sipas parashikimit ligjor të nenit 74 pika 3 të VKM 914/2014 i ndryshuar duhet të provojë me dokumentacion konkret se disponon 3 elektrikist, 3 hidraulik/mekanik, 3 murator, 2 pllakashtrues, 2 bojaxhi dhe 1 saldator, në procedurën e prokurimit objekt ankimi.

III.1.7. Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të paraqitur nga anëtari i bashkimit të përkohëshëm të operatoreve ekonomikë “Dion-AL” shpk shpk rezulton se ai disponon vetëm 3 murator dhe 1 bojaxhi për realizimin e kontratës objekt prokurimi. Ndërkohë nuk ka paraqitur dokumentacion provues se disponon ne stafin e tij punonjës me profesion elektrikist, hidraulik/mekanik, pllakashtrues dhe saldator.

Sa më sipër Komisioni gjykon se anëtari i bashkimit të përkohshëm të shoqërive “Dion-Al” shpk i cili ka përqindjen më të madhe në këtë bashkim, (55%) është në kushtet e mospërbushjes së kriterit të vecantë të kualifikimit pasi numri i punonjësve që ai disponon është më i vogël se ai që duhet të plotësohej referuar VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e cila në nenin 74 pika 3 e cila parashikon shprehimisht se: ”Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se me anë të kriterit të mësipërm, qëllimi i autoritetit kontraktor është vërtetimi se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dhe/ose anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë, në përputhje me nenin 74 pika 3 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar disponojnë stafin e nevojshëm (fuqinë punëtore) në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Me anë të dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Dion-Al” sh.p.k nuk ka vërtetuar se disponon fuqinë punëtore të nevojshme në përputhje me përqindjen e marrë përsipër për realizimin e kësaj kontrate.

III.1.8. Komisioni gjykon se përmbushja e kriterëve ekonomikë, teknike, profesionale në rastin konkret është një detyrim që buron nga ligji i cili në mënyrë taksative kërkon përmbushjen e tyre nga të gjithë anëtarët e bashkimit. Në këtë kuptim pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Eurondërtimi 2000” shpk & “Dion-Al” shpk se *“Ndarja e punimeve dhe fitimeve do të jetë në raportin 45 % për Eurondërtimi 2000 shpk dhe 55% Dion Al shpk por nuk është përmendur në asnjë vend një ndarje në % e angazhimit të mjeteve teknike, inxhinerike dhe financiare të secilit operator. Kjo do të thotë se në këtë procedurë ky bashkim operatorësh është trajtuar si një i tërë (si një operator i vetëm) me qëllim përmbushjen e kriterëve për realizimin e kësaj kontrate. AK e ka shumë të qartë që oferta është sjellë nga BOE Eurondërtimi 2000 shpk & Dion Al shpk dhe jo vetëm nga operatori Dion Al shpk, nuk është i bazuar pasi qëllimi i shprehur qartësisht në nenin 74 pika 3 e VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, është që secili nga operatorët e bashkimit të disponojë kapacitetet teknike profesionale në përputhje me përqindjen që kanë marrë përsipër të realizohet nga secili prej tyre. Ndarja në përqindje e kontributit dhe në terma konkretë të punëve për secilin anëtar të bashkimit nëpërmjet aktmarrëveshjes bëhet pikërisht në funksion të përmbushjes së kriterëve në atë masë apo në proporcion me atë që operatori ekonomik ka marrë përsipër të kryejë për realizimin me sukses të kontratës.*

Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor

përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

Referuar arsytimit më lart, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë "Eurondërtimi 2000" shpk & "Dion-Al" shpk nuk është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, pasi kriteri për disponimin e stafit të nevojshëm për realizimin e kontratës nuk është plotësuar nga anëtari i bashkimit "Dion-Al" shpk shpk pasi nga profesionet e kërkuara provon se disponon vetëm 3 muratorë dhe 1 bojaxhi duke mos qenë kështu në përputhje me përqindjen e marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit.

Sa më sipër pretendimi i BOE "Eurondërtimi 2000" shpk & "Dion-Al" shpk nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet mbi arsyet e tjera të skualifikimit të BOE "Eurondërtimi 2000" shpk & "Dion-Al" shpk, Komisioni i Prokurimit Publik, referuar arsytimit më sipër gjykon se nuk do të merren në shqyrtim për ekonomi të procedurës administrative pasi, gjendja faktike dhe juridike e këtij bashkimi do të vijojë të ngelet e skualifikuar edhe pas ankimit në KPP, duke mos pasur më interes të ligjshëm në lidhje me këtë procedurë prokurimi.

III.3. Lidhur me pretendimin e BOE ankimues mbi skualifikimin e operatorit ekonomik "Colombo" shpk ngritur pranë KPP, Komisioni gjykon se pretendimet në lidhje me operatorin "Colombo" shpk nuk janë ngritur pranë autoritetit kontraktor por vetëm pranë Komisionit të Prokurimit Publik duke mos ndjekur kështu shkallët e ankimimit në respekt të nenit 63 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, pika 2 dhe 7 parashikohet se: *"Ankesa kundër vendimeve të autoritetit kontraktor i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji"* (pika 2) *"Ankesa në Komisionin e Prokurimit Publik bëhet me formularin përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete, baza ligjore dhe përshkrimi i shkeljes, pretendimi i ankuesit për vendimin përfundimtar, shkallët e ankimit, shoqëruar me dokumentacionin përkatës dhe vendimin e autoritetit kontraktor. Elementet e mësipërme janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Komisioni i Prokurimit Publik e shqyrton ankesën në përputhje me LPP, Kodin e Procedurave Administrative dhe rregullat e prokurimit publik. Mosndjekja e shkallëve të ankimit e bën ankesën të pavlefshme"* (pika 7). Operatori ekonomik ankimues, në respektim të shkallëve të ankimimit, duhet të kishte paraqitur paraprakisht ankesë pranë autoritetit kontraktor për të gjitha pretendimet lidhur me operatorët e tjerë në këtë procedurë prokurimi, ashtu sikurse është përcaktuar specifikisht në ligjin e prokurimit publik. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se nuk mund të shprehet mbi pretendime të cilat nuk janë bërë paraprakisht objekt ankese pranë autoritetit kontraktor. Objekti i ankesës së paraqitur pranë autoritetit kontraktor në respekt të shkallëve të ankimimit nuk mund të shtohet në momentin e paraqitjes në KPP.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, për shkak të ligjit (*ipso lege*), pretendimet e BOE ankimes për operatorin “Colombo” sh.p.k të cilat nuk janë ankimuar fillimisht pranë autoritetit kontraktor, nuk mund të merren në shqyrtim nga KPP.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga BOE “Eurondërtimi 2000” shpk & “Dion-Al” shpk për procedurën e prokurimit, “*Procedurë e Hapur*”, me nr.REF-67868-08-05-2020, me objekt “*Rikonstrukcion i disa QSH- ve në qarqet Gjirokastër, Vlorë dhe Fier*”, me fond limit 130,414,007 lekë pa tvsh zhvilluar në datën 14.09.2020 nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1448 Protokoli, Datë 09.11.2020

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Jonaid Myzyri

